



Republika e Kosovës

Republic of Kosovo - Republika Kosova
Qeveria – Government -Vlada

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation /Ministarstvo Obrazovanja i
Nauke, Tehnologije i Inovacija

Tiranë, më 06.09.2024

Prishtinë, më 06.09.2024

KOMISIONI I PËRBASHKËT I SHQIPËRISË DHE KOSOVËS PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE TË PËRBASHKËTA PËR DIASPORËN

THIRRJE PËR APLIKIM PËR RECENSENTË PËR VLERËSIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN, NIVELI III

- Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta Mësimore për Diasporën, shpall thirrjen për aplikim **për recensentë për vlerësimin** e teksteve mësimore për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë **“Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli III.**
- Ftohen të aplikojnë individë që përmbushin kriteret e përcaktuara në paketën e dokumenteve të miratuara me Urdhrin/Vendimin e përbashkët, nr. 21, datë 13.01.2023, *“Për miratimin e paketës së dokumenteve për procedurën e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për diasporën, niveli II dhe niveli III”.*

3. Individu aplikon në linkun:

https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSdVOWhdyGAf0w6ZIJCmUBqlg7CDVds2I4vbda_nBSz3lFfqxHA/viewform

4. Aplikimet pranohen nga data 6-30 shtator.

5. Dokumentet e nevojshme për aplikim:

5.1. Specialist/ekspert sipas fushave:

- Dokument identifikimi;
- Jetëshkrimi (CV-ja);
- Diplomë e noterizuar e gradës shkencore në njërin nga fushat (gjuhë shqipe, letërsi, histori, gjeografi, kulturë muzikore, kulturë figurative);
- Dëshmi e titujve akademikë (nëse ka);
- Dëshmi të botimeve, pjesëmarrjeve në konferenca në fushën përkatëse;
- Dëshmi për përvojë në vlerësimin e teksteve mësimore (nëse ka);
- Vetëdeklarim mbi vërtetësinë e dokumenteve të dorëzuara.

5.2. Specialist/ekspert gjuhësor:

- Dokument identifikimi;
- Jetëshkrimi (CV-ja);
- Diplomë e noterizuar për ciklin e dytë të studimeve në gjuhë shqipe;
- Dëshmi të përvojës në redaktim gjuhësor në fushën e botimeve;
- Vetëdeklarim mbi vërtetësinë e dokumenteve të dorëzuara.

5.3. Mësues nga diaspora:

- Dokument identifikimi;
- Jetëshkrimi (CV-ja);
- Diplomë e noterizuar në mësuesi/mësimdhënie për ciklin fillor/klasor ose në njërin nga fushat e kurrikulës së mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në

diasporë dhe në mërgatë (gjuhë shqipe, letërsi, histori, gjeografi, kulturë muzikore, kulturë figurative).

- Dëshmi që është aktualisht mësues në diasporë;
- Dëshmi të përvojës së punës (së paku 5-vjeçare) si mësues i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare në diasporë;
- Dëshmi të kualifikimeve dhe trajnimeve në fushën e mësimdhënies (nëse ka);
- Vetëdeklarim mbi vërtetësinë e dokumenteve të dorëzuara.

6. Dokumentet duhet të ngarkohen në formatin pdf online në linkun:

<https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSdVOWhdyGAf0w6ZIJcmUBqlg7CDVds2I4vbdanBSz3lFfqxHA/viewform>

7. Për pyetje, lutemi na kontaktoni në adresën (info@qbd.gov.al)